



Në bazë të Ligjit të Punës të Kosovës nr. 03/L-212, në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin për Shoqëritë Tregtare të Kosovës, dhe nenin 6 të Rregullores për Marrëdhënien e Punës të “Trafiku Urban” SH.A. Bordi i drejtoreshave të N.P.K “Trafiku Urban” në mbledhjen e mbajtur me 21.08.2017 mori këtë vendim për shpalljen e vendeve të lira të punës në këto pozita:

- 1. Menaxher për transformim financiar**
- 2. Menaxher për transformim operativ**
- 3. Menaxher i transformimit**

1.Menaxheri për transformim financiar

Vendi i punës: **Menaxheri për transformimin financiar (“MTF”)**

Kualifikimi: Bachelor në financa ose fushë të ngjashme
Përvoja: 5 vite
Zgjedhja: Sipas Rregullores për Marrëdhënien e Punës
Elzekutues: 1 (një)

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Planifikon, zhvillon, organizon, zbaton, drejton dhe vlerëson operimet dhe performancën e përgjithshme financiare.
- Merr pjesë në zhvillimin e planeve dhe projekteve të TU si partner strategjik.
- Zhvillon kredibilitet duke ofruar analizë të saktë dhe në kohë të buxheteve, raporteve financiare dhe trendëve financiar që të asistojë Kryeshefin Ekzekutiv, Bordin dhe drejtuesit tjerë të lartë gjatë kryerjes së përgjegjësisë të tyre.
- Mbronë dhe ngritë kredibilitetin e Trafiku Urban, si zhvillues efektiv i zgjedhjeve të sfidave komplekse në kompani.
- Merr pjesë në zhvillimin e biznesit të ri. p.sh. të asistojë Kryeshefin Ekzekutiv.
- Mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e blerjes dhe listës së pagave për stafin dhe pjesëmarrësit.

Arsimi dhe përvoja e preferuar

- Diplomë Master në fushë financiare
- Së paku 3 vite përvojë në fushë të ngjashme

2.Menaxheri për transformim operativ

Vendi i punës: **Menaxheri për transformimin operativ (“MTO”)**

Kualifikimi: Bachelor në fushat teknike ose të ngjashme

Përvoja: 5 vite

Zgjedhja: Sipas Rregullores për Marrëdhënien e Punës

Ekzekutues: 1 (një)

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Ofron lidhshmëri dhe menaxhment të përditshëm për një organizatë shërbyese e cila pasqyron misionin dhe vlerat kryesore të përshtatura nga Trafiku Urban.
- Planifikon, menaxhon dhe vlerëson operimin e të gjitha funksioneve të Transportit Publik dhe Mirëmbajtjes.
- Drejton zbatimin e rregullave, rregulloreve dhe politikave mbi procedurat e transportit dhe mirëmbajtjes, si dhe këshillohet me stafin vartës lidhur me aktivitetet dhe veprimet.
- Përgjegjës për matjen dhe efektivitetin e të gjitha proceseve të brendshme dhe të jashtme. Ofron raportet me kohë, të sakta dhe të plota mbi kushtet operative të Trafiku Urban.

Arsimimi dhe përvoja e preferuar

- Diplomë Master në fushë teknike apo të përafërt.
- Së paku 3 vite në një rol të menaxhmentit të lartë.

3.Menaxheri i transformimit

Vendi i punës: **Menaxheri i transformimit (“MT”)**

Kualifikimi: Bachelor në zinxhirin e furnizimit, inxhinieri industriale, inxhinieri, administrim biznesi apo ekonomiks

Përvoja: 5 vite

Zgjedhja: Sipas Rregullores për Marrëdhënien e Punës

Ekzekutues: 1 (një)

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Udhëheqë ekipet e projektit në mbështetje të rrjedhave të ndryshme të punës së projektit, dhe menaxhon aktivitetet , planet dhe terminet e përgjithshme të projektit të lidhura me rezultatet dhe arritjet e synimeve.
- Udhëheqë, udhëzon dhe mbështetë krerët/këshilluesit e shumtë të rrjedhës së punës përmes dizajnit dhe zbatimit të strategjive të synuara të ndryshimit, përfshirë identifikimin e ndikimit të ndryshimit tek njerëzit, proceset, politikat dhe strukturat,
- Kryeson zhvillimin, komunikimin dhe zbatimin e strategjive dhe proceseve efektive të rritjes.
- Planifikon dhe menaxhon ndryshimin dhe zhvillimin e punës, së bashku me KSHE, MTO dhe ZKF lidhur me modernizimin e shërbimeve, funksioneve mbështetëse për të krijuar ndryshim efektiv dhe të qëndrueshëm.

Arsimimi dhe përvoja e preferuar

- Diplomë Master në zinxhirin e furnizimit, inxhinieri industriale, inxhinieri, administrim biznesi apo ekonomiks
- Së paku 5 vite në një rol të menaxhmentit të lartë.

INFORMATË PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT

Kandidatët për këto pozita duhet t'i dorëzojnë provat e mëposhtme:

- CV-në,
- Dëshmi mbi kualifikimin shkollor.
- Letër motivimi,
- Dëshminë mbi përvojën e punës,
- Certifikatën që nuk është nën hetime dhe
- Certifikatën e shtetësisë së Kosovës.

Data e shpalljes së Konkursit : 24.08.2017 deri me dt. 25.09.2017

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në adresën NPK "Trafiku Urban", Rr."Tahir Zajmi", p. n.-Prishtinë, ose personalisht në objektin e ndërmarrjes.

Në aplikacion duhet te ceket qartë titulli i vendit te punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet te jenë kopje dhe nuk kthehen.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e shpalljes.

Informatat shtesë mund të sigurohen përmes numrit të telefonit: 044 340 923.